



HAL
open science

Turizmi kulturor e arkeologjik - roli i tij në zhvillimin ekonomik të Durrësit

Enika Abazi

► **To cite this version:**

Enika Abazi. Turizmi kulturor e arkeologjik - roli i tij në zhvillimin ekonomik të Durrësit. *Economicus*, 2009, 4, pp.145-154. hal-01552168

HAL Id: hal-01552168

<https://hal.science/hal-01552168>

Submitted on 30 Jun 2017

HAL is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.

ECONOMICUS 4

KRYEREDAKTOR: ADRIAN CIVICI

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT EKONOMIK
NR. 4, VJESHTË 2009

TURIZMI KU PO SHKON?!

Politikat strategjike për zhvillimin e turizmit në Shqipëri
E. NOTI

Politikat të turizmit rural dhe promovimi i destinacioneve turistike
A. CAPRIELLO

Ndihma e statistikës në politikat dhe zhvillimin e turizmit
F. MEMAJ - E. ZYKA - E. TOMORI

Pasojat e përdorimit jo efektiv të tokës në sektorin turistik
F. GURI - N. HODAJ - J. XHEMALI - E. KOKTHI

Efekti i turizmit në rritjen e qëndrueshme ekonomike
J. KRISTO

Modeli ekonomik i transformimit të monumenteve
historiko-kulturore në objekte turistike
L. MINXHOZI - E. GJEBREA

Turizmi kulturor në Shqipëri dhe hapësira e tij Mesdhetare
K. BELLO - J. KËLLEZI - A. PAPALLAZO - T. OELFKE

Promocioni, element i rëndësishëm i strategjisë së turizmit
L. AGORA - A. TEMO

Turizmi rural në Shqipëri – modele dhe sfida
Sh. MARKU - T. TRESKA

Optimizimi i investimeve energjetike në zonat turistike
E. KRIPA - A. SHKURTI

Turizmi kulturor e arkeologjik - roli i tij në zhvillimin të Durrësit
E. ABAZI

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shkodër
N. XHINDI - W. HELLER

Tirana, një realitet i prekshëm për zhvillimin e turizmit
O. ZOTO - A. HOTI - A. ALLAMANI

Cilësia e shërbimeve dhe marketingu i brendshëm
- rasti i hoteleve bregdetare
E. BAZINI - L. ELMAZI



<i>Turizmi rural në Shqipëri – modele dhe sfida</i> DR. SIKËLZEN MARKU – DR. TOMI TRESKA	130
<i>Optimizimi i investimeve energjetike në zonat turistike</i> M.A. ERMELA KRIPA – M.SC. ARANIT SIKURTI	137
<i>Turizmi kulturor e arkeologjik – roli i tij në zhvillimin ekonomik të Durrësit</i> PROF. AS. DR. ENIKA ABAZI	145
<i>Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shkodër</i> DR. NEVILA XIHINDI – PROF. WILFRIED HELLER	155
<i>Tirana, një realitet i prekshëm për zhvillimin e turizmit</i> M.A. OLIJANA ZOTO – M.A. ARLINDA HOTI – M.A. ARETA ALLAMANI	164
<i>Udhëtimi jashtë vendit dhe faktorët kulturorë dhe psikografikë</i> <i>Rasti i Shqipërisë dhe Maqedonisë</i> DR. JOVAN STOJANOSKI – DR. KLIME POPOSKI – PROF. AS. DR. LILJANA ELMAZI	172
<i>Promocimi i turizmit në Greqi</i> M.A. ELENI SKARVELI	180
<i>Cilësia e shërbimeve dhe marketingu i brendshëm – rasti i hoteleve bregdetare</i> EVELINA BAZINI – PROF. AS. DR. LILJANA ELMAZI	185
<i>Turizmi mjekësor (kurativ)</i> ELONA SHEHU – JONILDA HONJIA	193
<i>Sfida dhe probleme të sistemit të thesarit në Ministrinë e Financave</i> ANI DASHO SHARKO MSc.Eng	199
<i>Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë. Pasojat e saj mbi bujqësinë dhe turizmin</i> ALBAN PLLAHA (MIB)	208

Turizmi kulturor e arkeologjik – roli i tij në zhvillimin ekonomik të Durrësit

Prof. As. Dr. Enika Abazi

Universiteti European i Tiranës, Shqipëri

ABSTRAKT. *Durrësi ka një potencial të madh për zhvillimin e turizmit dhe sektorëve të tjerë mbështetës nepermjet kombinimit të turizmit bregdetar me atë kulturor dhe arkeologjik. Një kombinim i tillë do ta shtrinte aktivitetin turistik përgjatë gjithë vitit dhe do të kontribuonte ndjeshëm në rritjen e të ardhurave nga turizmi dhe në zhvillimin ekonomik e social të rrethit. Një realitet i tillë ende mungon në Durrës si rezultat i mungesës së infrastrukturës logjistike të përshtatshme dhe informacionit të nyajtueshëm në nivel institucional që lidhet kryesisht me organizimin e pamyajtueshëm të zyrave të informacionit që mendojë se duhet të marrin përsipër me shumë përgjegjësi për përpunimin, paraqitjen dhe qarkullimin e të dhënave rreth vlerave kulturore dhe arkeologjike të rrethit.*

Hyrje

Turizmi ka potencial që të transformojë shoqërinë dhe kulturën e një vendi. Turizmi është shpesh katalizator për ndryshime të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore, kontekst për shkëmbimin ndërmjet kulturave dhe skenë për manifestimin e kulturave dhe traditave. Kështu nga zhvillimi i turizmit ekonomik lokale fuqizohen si pasojë e rritjes së investimeve të drejtpërdrejta ose në sektorët mbështetës, zgjerimit të mundësive të punësimit si dhe intensifikimit të fluksit dhe qarkullimit monetar. Me të drejtë turizmi konsiderohet nga qeveria shqiptare si një sektor strategjik që përcillet me vëmendje të veçantë në programet e zhvillimit të vendit dhe projektimit të imazhit të tij. Në këtë kuadër turizmi është bërë pjesë e mesazheve promociionale të subvencionuara nga qeveria në kanale prestigjioze si CNN që ndër të tjera promovojnë përveç zhvillimit të turizmit, terheqjen e investimeve të huaja si dhe imazhin e vendit nëpër botë.

Kur flasim për turizmin duhet të kemi parasysh se aktiviteti turistik është shumë i larmishëm, sikundër janë edhe ndikimet e tij në zhvillimin ekonomik, kulturor e social të një vendi apo bashkësie lokale. Gjithsesi, në këtë punim do të fokusohem në turizmin kulturor e arkeologjik, kryesisht në rrethin e Durrësit, në mundësitë që ekzistojnë si dhe

në shfrytëzimin e tyre për zhvillimin ekonomik të tij. Durrësi ka një potencial të madh për zhvillimin e turizmit dhe sektorëve të tjerë mbështetës nëpërmjet kombinimit të turizmit bregdetar me atë kulturor dhe arkeologjik.

Një kombinim i tillë do ta shtrinte aktivitetin turistik përgjatë gjithë vitit dhe do të kontribuonte ndjeshëm në rritjen e të ardhurave nga turizmi dhe në zhvillimin ekonomik e social të rrethit. Një realitet i tillë ende mungon në Durrës si rezultat i mungesës së infrastrukturës logjistike të përshtatshme dhe informacionit të mjaftueshëm në nivel institucional që lidhet kryesisht me organizimin e pamjaftueshëm të zyrave të informacionit që mendoj se duhet të marrin përsipër më shumë përgjegjësi për përpunimin, paraqitjen dhe qarkullimin e të dhënave rreth vlerave kulturore dhe arkeologjike të rrethit.

Ky punim mbështetet në një anketim i cili ka identifikuar interesin për një turizëm ndryshe nga ai i plazhit bregdetar që ofrohet në Durrës, si dhe deri në çfarë mase infrastruktura turistike ekzistuese dhe institucionet publike lokale e qendrore janë të gatshme për ta zhvilluar atë. Përdorimi i anketimit në fushën e turizmit është një metodë shkencore që përdoret në shumë vende me turizëm të konsoliduar siç janë Franca, Italia, Spanja, Greqia etj. Rëndësia e tij qëndron në grumbullimin e shpejte të informacionit sidomos në fusha të aktiviteti që njihen për dinamizmin e tyre. Duke u nisur nga këto premisa anketimi mendohet i ka shërbyer nevojave të këtij punimi që synon një vëzhgim të përgjithshëm e të shpejtë mbi problematikat e zhvillimit të turizmit kulturor e arkeologjik në rrethin e Durrësit.

Punimi është i organizuar në tre pjesë. Në pjesën e parë të këtij punimi jepet një përcaktim dhe kuptim i turizmit kulturor dhe arkeologjik në përgjithësi. Në pjesën e dytë paraqiten dhe interpretohen të dhënat e studimit për nivelin e zhvillimit të këtij turizmi në rrethin e Durrësit. Punimi përmbyllet me disa reflektime dhe rekomandime për ndryshimin e gjendjes.

Çështje përkufizimi

Para se gjithash është me vend të sqarojmë konceptin e turizmit kulturor e arkeologjik. Në shumicën e rasteve turizmi kulturor e arkeologjik kuptohet si udhëtimi i motivuar i turistëve nga kultura dhe historia e një rajoni apo vendi të caktuar në përgjithësi dhe në veçanti nga arti, monumentet dhe zonat arkeologjike në të (Zeppel, 1992, Ap, 1999). Turizmi kulturor e arkeologjik shihet i fokusuar në vizitimin e komuniteteve tradicionale të cilat kanë praktika sociale, forma të veçanta të artit, doke e zakone të ndryshme, monumente dhe hapësira arkeologjike, që shënon dhe ndryshimin nga format e tjera të turizmit.

Për disa të tjerë më shumë se një udhëtim i motivuar turizmi kulturor e arkeologjik është një ndërveprim midis njerëzve, vendeve dhe trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike (Zeppel and Hall, 1991). Turizmi kulturor dhe arkeologjik nënkupton përdorimin e aseteve në zonat urbane, qytete historike ose qytetet e mëdha dhe institucionet e tyre kulturore si muzetë, teatrot apo sallat koncertore. Ai nënkupton dhe turizmin në zona

rurale përfshi organizimin e festivale kulturore dhe të paraqitjes së traditës në këto zona.

Për Bob McKercher e Hilary du Cros turizmi kulturor përfshin katër elemente: turizmin, përdorimin e aseteve të trashëgimisë kulturore, konsumin e eksperiencave dhe produkteve, dhe turistin (2002: 6). Duke bërë kombinimin e këtyre faktorëve të dy autorët japin këtë përkufizim "turizmin kulturor është një veprimtari turistike në të cilën asetet e trashëgimive kulturore paraqiten për konsumim nga turisti" (McKercher and du Cros, 2002: 9). Kështu turizmi kulturor dhe arkeologjik, përveç se një veprimtari argëtimi, përfshin edhe transformimin në "produkt" të komercializueshëm të traditave dhe vlerave kulturore. Një përjasje e tillë e turizmit kulturor e arkeologjik është mbajtur parasysht edhe në hartimin e anketimit që është zhvilluar për qëllimet e këtij punimi.

Duhet mbajtur parasysht se komercializimi i aseteve të trashëgimive kulturore dhe arkeologjike si pjesë e veprimtarisë turistike bën që ai të "klasifikohet në ditët tona midis dy skajesh të idealizuar: ose si thellësisht pozitiv ose si thellësisht negativ" (Doja, 2007). Këndvështrimi negativizues i zhvillimit të turizmit kulturor e arkeologjik sjell në vëmendje varësinë që krijohet nga flukset monetare të turistëve, erozionin e vlerave kulturore e arkeologjike pas komercializimit dhe shfrytëzimit të tyre pa kriter, si dhe shqetësimin e bashkësisë lokale lidhur me erodimin e burimeve të jetesës së përditshme. Këndvështrimi pozitivizues i një "transformimi" të tillë nënkupton rritjen e të ardhurave dhe të punësimit lokal sikundër dhe ri-vlerësimin dhe rritjen e dukshmërisë së vlerave, monumenteve dhe zonave kulturore e arkeologjike, por dhe mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tyre në kuadrin e komercializimit turistik. Ky është këndvështrimi i cili do të trajtohet gjerësisht në këtë punim.

Turizmi kulturor e arkeologjik ka filluar të bëhet popullor këto vitet e fundit në Europë. Kështu në vartësi të burimit apo destinacionit mendohet se 35 deri në 70 përqind e turistëve konsiderohen turistë kulturorë (Antolovic, 1999). Nga studimet e bëra pranohet se turisti kulturor harxhon më shumë se turisti i zakonshëm ndaj mendohet që ai ka një ndikim më të madh në zhvillimin ekonomik të lokalitetit në veçanti dhe vendit në përgjithësi.

Turizmi kulturor dhe arkeologjik fillon të dallohet si një shërbim i veçantë në fillim të viteve 70-të kur disa studiues vunë re se një kategori turistesh udhëtonin për të vizituar dhe kuptuar trashëgimin kulturore dhe monumentet arkeologjike (Tighe, 1986). Në vitin 1976, Komiteti Shkencor Ndërkombëtar për Turizmin Kulturor – Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve dhe Hapësirave (ICOMOS) – miratoi Kartën e Turizmit Kulturor. Qëllimi kryesor i një sipërmarrjeje të tillë ishte tërheqja e vëmendjes për ekzistencën e vlerave arkeologjike dhe kulturore duke ndihmuar në krijimin e një imazhi të ndryshëm të qyteteve, mbrojtjen e kulturës dhe mirëmbajtjen e monumenteve arkeologjike, hapjen e perspektivës për zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë nëpërmjet krijimit të lidhjeve ndërmjet interesit të pushimeve dhe turizmit kulturor. Një kombinim i tillë inkurajon shtrirjen e turizmit gjatë gjithë vitit, zhvillimin e shërbimeve dhe aktivitetëve të tjera mbështetëse (artizanat, transport, agrikulturë, ndërtim, etj), si dhe nxit hartimin e politikave që synojnë respektimin e intimitetit të vendasve dhe ruajtjen e monumenteve, hapësirave arkeologjike dhe vlerave kulturore të ekspozuara nga dëmtimet e mundshme.

Turizmi në Durrës

Zhvillimi i turizmit në rrethin e Durrësit është një prioritet e në të njëjtën kohë një domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik, kulturor e social të rrethit. Megjithatë, zhvillim vetëm i turizmit tradicional të plazhit nuk mjafton për një zhvillim të qëndrueshëm, efektiv e perspektiv të rrethit. Kjo për vetë faktin se ai shtrihet kryesisht gjatë sezonit të verës dhe turisti është thjesht një shpenzues i infrastrukturës dhe shërbimeve që ofrohen në zonën e plazhit dhe gjeneron të ardhura që në pjesën më të madhe shërbejnë për vetëshlyerjen e investimeve themelore dhe korrente në zonën e plazhit. Nga një përllogaritje e përafërt e bërë nga departamenti i Ekonomiksit të fakultetit Ekonomik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, investimet themelore të kryera në plazhin e Durrësit kërkojnë 15-20 vjet që të shlyejnë veteten.

Ndërkohë që zona e plazhit të jetë funksionale dhe e preferuar kërkon që të kryhen edhe shumë investime të tjera në infrastrukturë, shërbime dhe ambiente e aktivitete argëtimi. Nga ky krahasim i përgjithshëm i shpenzimeve me të ardhurat nga zona e plazhit del qartë se më shumë duhet bërë për të rritur nivelin e gjenerimit të të ardhurave e për pasojë edhe të investimeve që do të rrisin atraktivitetin e zonës së plazhit të Durrësit. Ky qark vicioz duket se nuk lë shumë hapësirë për ndryshime të qenësishme në gjendjen aktuale të zhvillimit të turizmit në plazhin e Durrësit.

Ndërkohë kombinimi i turizmit të zakonshëm me atë kulturor e arkeologjik në Durrës hap perspektiva për zhvillim ekonomik dhe social nëpërmjet shtrirjes së turizmit gjatë gjithë vitit, zhvillim të shërbimeve dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse si artizanati, transporti, agrikultura, ndërtimi, muzeologjia, etj. Për më tepër që nga studimet e bëra pranohet se turisti kulturor harxhon më shumë se turisti i zakonshëm. Nga ana tjetër ky kombinim tërheq vëmendjen për ekzistencën e vlerave arkeologjike dhe kulturore duke ndihmuar në krijimin e një imazhi ndryshe të qytetit të Durrësit, mbrojtjen e kulturës dhe monumenteve arkeologjike dhe mirëmbajtjen e tyre. Një kombinim i tillë nuk është diçka e re, sikundër që në vitin 1976 është adoptuar Karta për Turizmin Kulturor nga ICOMOS dhe në Europë ai ka filluar të bëhet popullor dekadat e fundit. Mbetet që të përfitojmë nga eksperiencia më e mire e vendeve të tjera dhe ta adaptojmë atë në kushtet e Durrësit.

Shumë flitet për bërjen e turizmit kulturor një prioritet të zhvillimit të turizmit në Shqipëri në përgjithësi dhe në Durrës në veçanti, por është e rëndësishme të krijojmë një ide të qartë se ku jemi me zhvillimin e tij. Nga një anketim kompleks i organizuar nga fakulteti i Ekonomisë së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës rezultoi se në praktikë jemi shumë larg zhvillimit të një turizmi kulturor në rrethin e Durrësit, për shkak të një sërë arsyesh të cilat u evidentuan.

Anketimi parqet një qasje të dyfishtë. Në njërin anë ai teston njëkohësisht dëshirën e turistit vendas për një kombinim të turizmit të plazhit me atë arkeologjik e kulturor dhe njohuritë dhe informacionin që ai ka për ekzistencën e vlerave kulturore dhe arkeologjike në rrethin e Durrësit. Këto dy informacione janë të rëndësishme në vlerësimin e ekzistencës së premisë fillestare për kombinimin e llojeve të turizmit. Nga ana tjetër anketimi nxjerr në


pah përgatitjen e hoteleve apo agjencive turistike në qytetin e Durrësit për të ofruar informacion dhe shërbime të ndryshme në mbështetje të zhvillimit të turizmit kulturor dhe arkeologjik.

Suksesi i anketimit qëndron si në përgatitjen e pyetjeve, për saktësimin e madhësisë së kampionit/mostrës po ashtu dhe në mënyrën e realizimit të saj. Për anketimin u përgatitën pyetësorë që mbledhën në mënyrë indirekte informacionin për interesin e pushuesve për turizmin kulturor e arkeologjik si dhe për ofertën turistike të hoteleve dhe agjencive turistike. Në qasjen e parë një zgjedhje (sample) prej 50 qytetarësh të rastësishëm në qytetin e Durrësit dhe Tiranës është intervistuar. Ndërsa për qasjen e dytë 30 hotele dhe agjenci turistike në zonën e qytetit të Durrësit dhe Plazhit janë marrë në telefon. Për efekte të studimit një listë e objekteve arkeologjike, historike dhe muzeale më të rëndësishme në qytetin e Durrësit është nxjerr nga guida arkeologjike të qytetit të Durrësit në internet dhe publikimeve të përgatitura në qytetin e Durrësit në bashkëpunim me institucione të specializuara brenda dhe jashtë vendit.

Një listë e aktiviteteve kulturore që zakonisht zhvillohen në qytetin e Durrësit gjatë të gjithë vitit, është përpunuar duke ju referuar të dhënave të Bashkisë Durrës dhe NGO-ve të rrethit. Pas realizimit të anketave një element tjetër i rëndësishëm është përpunimi statistikor i të dhënave dhe nxjerrja e treguesve të rëndësishëm që kanë ndikim në zhvillimin e turizmit kulturor e arkeologjik. Duke u nisur nga përmasat e anketimit është e qartë se studimi ka si qëllim paraqitjen në vija të përgjithshme të nivelit dhe problematikave të zhvillimit të turizmit kulturor e arkeologjik në Durrës më shumë se sa përllogaritjen e treguesve ekonomike analitike. Sigurisht pas një identifikimi të situatës do të ishte me interes organizimi i një studimi më të detajuar dhe analitik për çdo element të veprimtarisë turistike në rrethine Durrësit, që sidoqoftë nuk është objekt i këtij punimi që qëndron modest në objektivat e tij.

Në vijim paraqiten në mënyrë grafike dhe të interpretuara të dhënat e anketimit. Grafiku 1, jep një ide të objekteve arkeologjike e historike të përzgjedhura, të shpërndara sipas shpeshërisë së frekuentimit të tyre nga turistët.

Grafiku 1. Objektet arkeologjike të vizituara në rrethin e Durrësit



Nga anketimi rezulton se nga turistët vendas që kanë qenë në plazhin e Durrësit shumë pak prej tyre kanë vizituar objekte arkeologjike, historike apo muzeale. Kështu 58 përqind e turistëve nuk kanë bërë asnjë vizitë me interes arkeologjik, historik apo muzeal në rrethin e Durrësit. Ndërsa ndër objekte e vizituara janë Amfiteatri Romak, Vila e Mbretit Zog, Muzeu arkeologjik, Kisha e Shën Antonit, dhe ajo katolike, mbetjet e kështjellës së Skënderbeut, xhamia e madhe, etj. Ndërkohe që ka një numër tepër të vogël vizitueshëm për pasuritë mozaike, e objekte të trashëgimisë romake e bizantine me të cilat Durrësi është bujarisht i pasur dhe që janë të vlerësuara edhe ndërkombëtarisht.

Arsyeja për një situatë të tillë dëshpëruese i atribuohet mungesës së informacionit në 44 përqind të rasteve dhe mosdijes në 32 përqind të rasteve. 24 përqind e të intervistuarve e gjykojnë të vështirë realizimin e vizitave në këto objekte. Kjo situatë paraqitet e plote edhe në Grafikon 2.

Grafiku 2: Informacioni për objektet arkeologjike dhe evenimentet kulturore




Ndërkohe që grafikët 1 dhe 2 ofrojnë një pikturë shumë të përgjithshme të nivelit të zhvillimit të turizmit arkeologjik e historik në rrethin e Durrësit, Grafiku 3 tregon interesin e turistëve vendas për të kombinuar pushimet në plazh me aktivitete kulturore që dëshirohet nga 58 përqind turistëve ndërkohe që 37 përqind prej tyre dëshirojnë vizita në objektet arkeologjike.

Grafiku 3. Potenciali i aktiviteteve shoqëruese me plazhin



Sigurisht preferenca e turistëve për të ndjekur aktivitete kulturore ndërkohë që janë me pushime në Durrës ose jo janë të ndryshme për veprimtari të ndryshme. Grafiku 4 jep një pamje të këtyre preferencave.

Grafiku 4: Preferencat për frekuentimin e veprimtarive kulturore



Preferencat për ndjekje të aktivitete kulturore janë më shumë në favor të Festivalit të Detit, karnavaleve, poetikës etj.

Ndërkohë që dëshira e turistëve vendas nuk mungon për të marrë pjesë në aktivitet kulturore e vizita në zona historike e arkeologjike ndërkohë që kalojnë pushimet në buzë të detit, mbetet të shikohet se cilat janë alternativat që ofrohen në plotësim të këtyre dëshirave nga operatorët direkt siç janë hotelet e agjencitë turistike dhe zyrat e informacionit pranë baskisë dhe institucioneve të tjera publike në rreth e më gjerë.

Nga bisedat telefonike me disa prej hoteleve dhe agjencive që operojnë në qytetin dhe në plazhin e Durrësit rezulton se në pjesën më të madhe ato të përmasave të mesme (kaki) nuk ofrojnë paketa për vizita turistike në zonat arkeologjike të qytetit ndërkohë që japin informacion gjithësesi të pa specializuar. Njësitë e vogla (ngjyre jeshile në grafik) nuk kanë as informacionin më minimal për zonat arkeologjike dhe historike të rrethit. Përfundimisht bëjnë hotelet e mëdha (portokalli) me më shumë se 100 shterorë, si Adriatiku që ofron informacion, ndonëse jo të specializuar, dhe mundësi për vizita në këto zona. Grafiku 5 jep në mënyrë më të përmbledhur një pikturë të situatës.

Grafiku 5: Ofirta e hoteleve për vizita në objektet arkeologjike dhe zonat historike



Rezultatet janë pothuajse të njëjta për ofertën e hoteleve për aktivitetet kulturore. Ndërkohë që hotelet ofrojnë pak shërbime të tjera përveç atyre të hotelerisë dhe restorant-barit kërkesa e turistëve për informacion për objektet arkeologjike e historike në qytetin dhe rrethin e Durrësit është e ndjeshme. Kështu nga të dhënat e anketimit rezultoi se 48 përqind e të intervistuarve nuk kanë informacion për zonat arkeologjike dhe historike ndërkohë që 44 përqind e tyre kanë kërkuar informacion, ndërsa vetëm 8 përqind e të intervistuarve nuk kanë interes për informacion.

Nga intervistat me hotelet dalin në pah një sërë problemesh që kanë të bëjnë me arsyt e ofertës së munguar për paketa vizitash në aktivitet kulturore apo zonat arkeologjike. Mund të përmendim mungesën e informacionit dhe guidave e hartave të specializuara të rrethit të Durrësit, suvenirëve që i referohen trashëgimisë kulturore, historike dhe arkeologjike, shërbimit të transportit publik të specializuar që lehtësojnë shkuarjen e lirë në këto objekte apo aktivitete, informacion për orarin e aktivitet kulturore apo vizitave në zonat arkeologjike.

Nga ana tjetër mbetet të shihet se sa të disponueshme, atraktive dhe lehtësisht të vizitueshme janë zonat historike e arkeologjike si dhe cilat janë shërbimet që ofrohen në vendndodhje. Nga një vëzhgim personal gjendja lë shumë për të dëshiruar. Por si do qoftë një anketim tjetër më i specializuar duhet bërë për të evidentuar në mënyrë më të detajuar situatën dhe problematikën që pengojnë zhvillimin e turizmit kulturor dhe arkeologjik në rrethin e Durrësit.

Konkluzione dhe Rekomandime

Nga rezultatet e studimit, nxjerrim konkluzionin që ka ende shumë për të bërë që kërkesat në rritje për zhvillimin e turizmit kulturor, arkeologjik e historik të përputhen në sasi dhe cilësi me ofertën turistike. Disa rekomandime mund të bëhen që do të çonin në një përmirësim të shpejtë të situatës.

Të regjistrohen dhe të krijohet një database elektronike lehtësisht e vizitueshme e përditësuar, e cila i duhet vënë në dispozicion të hoteleve, operatorëve turistik, turistit për:

- Siter historike
- Zonat Moderne të Distriktit
- Parqet dhe Klubet Tematike
- Ekosistemet bregdetare
- Natyra e Virgjër
- Aktivitetet kulturore

Të projektohet një imazh ndryshe i qytetit të Durrësit duke:

Planifikuar Destinacionet dhe aktivitetet të ndryshme të një karakteri të veçantë e përfaqësuese

- Planifikuar Burimet në Destinacione dhe aktivitete
- Planifikim i Guideve
- Planifikimi i të dhënave që do të kërkonte mbledhjen e të dhënave nga/për:
 - o Biblioteka, Interneti, dhe anketime
 - o Regjistrimi i popullsisë dhe Analiza Statistikore
 - o Të dhënat për pozicionimin
 - o Burimet e të dhënave
 - o Institucionet bazë
 - o Krijimin e imazhit të zonës
 - o Promovimin e pasurive të zonës

Llogaritja e rezultatit të munguar:

- Përlllogaritja e kapaciteteve akomoduese në Durrës.
- Përlllogaritja e turistëve që mund të akomodohen
- Përlllogaritja e turistëve të pritsëm gjatë gjithë vitit
- Përlllogaritja e shërbimeve dhe aktivitetëve mbështetëse

Me qëllim që një sipërmarrje e tillë të jetë e suksesshme krahas një veprimi të kombinuar me ndarje detyrash e përgjegjësish ndërmjet institucioneve publike e private në kuadrin lokal e me gjerë, duhet edhe një studim i mirëfilltë me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar.

Literatura

- Antolovic, J. (1999) "Immovable Cultural Monuments and Tourism." In Cultural Tourism Session Notes XII Assembly ICOMOS. Mexico, pp. 103-118.
- Ap, J. (1999) An analysis of tourism policy development in modern China. *Tourism Management*, 20(4), 471-485.
- Doja, A. (3 July 2007) "Leading and Building Research Capability in the Field of Critical Tourism Studies". Open lecture at The Centre for Tourism and Cultural Change, Leeds Metropolitan University, UK.

- Durrës Regional Development Strategy, (2005), Tirana: PNUD and High Region Authority
- Durrës in Figures, (2005) Durrës: High Region Authority
- McKercher, B. and Du Cros, H. (2002) "Cultural Tourism. The partnership between Tourism and Cultural Heritage Management", New York: The Haworth Hospitality Press
- Tighe, A. J. (1986) "The Arts/Tourism Partnership" *Journal of Travel Research* 24: 2-5.
- Zeppel, H. (1992) "The Festival of Pacific Arts: an emerging special interest tourism event". in: Betty Weiler and C. Michael Hall (eds), *Special Interest Tourism*. London: Belhaven Press. pp. 69-82.
- Zeppel, H. and Hall, M. (1991) "Selling art and history: Cultural heritage and tourism", *Journal of Tourism Studies* 2 (1) pp. 29-45.